



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

Nr. 14 Prot.

Tiranë, më 11 / 10 /2018

VENDIM

Nr. 6, datë 11. 10. 2018

“MBI
SHPËRNDARJEN E PJSËS TAKUESE TË SHPËRBLIMEVE PËR ANËTARËT
PRODHUES TË ISH-AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV PËR TË
DREJTAT E PRODUCENTËVE - AMP”.

Bazuar kërkesës së ish-agjencisë AMP, depozituar në Ministrinë e Kulturës me nr. 6546 prot, datë 13.8.2018, si dhe në zbatim të nenit 156 të ligjit nr. 35, datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 35, datë 18.01.2017 “Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit”; vendimit nr.2, datë 20.04.2017 “Për miratimin e rregullores të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA)”, Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit,

V E N D O S I:

1. Likujdimin e pagesave të shpërblimit kundrejt anëtarëve/prodhues të ish-agjencisë së administrimit kolektiv për të drejtat e producentëve “AMP”, brenda datës 30.11.2018, nga ana e Sportelit Unik – SUADA, deri në periudhën kur licenca e këtij subjekti ka qenë brenda afateve të vlefshmërisë.
2. Ngarkohet Këshilli Mbikqyrës i Sportelit Unik - SUADA për përlllogaritjen e shpërblimeve takuese për ish-agjencinë AMP.
3. Ngarkohet Sportelit Unik - SUADA për njoftimin e anëtarëve të ish-agjencisë AMP për kalimin e shumës takuese.
4. Ngarkohet sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit për njoftimin e këtij vendimi.

SEKRETAR TEKNIK

SOFJAN JAUPAJ

KRYETAR
INES MUÇOSTEPA